

LIGJ
Nr. 59/2025

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROTOKOLLIN SHITESË
TË KONVENTËS PËR KONTRATËN E TRANSPORTIT RRUGOR
NDËRKOMBËTAR TË MALLRAVE (CMR), NË LIDHJE ME FATURËN
ELEKTRONIKE TË NGARKESËS, BËRË NË GJENEVË, NË DATËN 20.2.2008**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në protokollin shtesë të Konventës për Kontratën e Transportit Ndërkombëtar Rrugor të Mallrave (CMR), në lidhje me faturën elektronike të ngarkesës, bërë në Gjenevë, në datën 20.2.2008, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 30.10.2025.

Shpallur me dekretin nr. 393, datë 17.11.2025, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

PROTOKOLL SHITESË
I KONVENTËS PËR KONTRATËN E TRANSPORTIT RRUGOR NDËRKOMBËTAR TË
MALLRAVE (CMR), NË LIDHJE ME FATURËN ELEKTRONIKE TË NGARKESËS

Palët e këtij Protokolli,

duke qenë Palë të Konventës për Kontratën për Transportin Rrugor Ndërkombëtar të Mallrave (CMR), të bërë në Gjenevë, më 19 maj 1956;

duke dëshiruar të plotësojnë Konventën, me qëllim lehtësimin e hartimit opsional të faturës së ngarkesës me anë të procedurave të përdorura për regjistrimin dhe trajtimin elektronik të të dhënave,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Përkufizime

Për qëllimet e këtij Protokolli,

“Konventë” nënkupton Konventën për Kontratën e Transportit Rrugor Ndërkombëtar të Mallrave (CMR);

“Komunikim elektronik” nënkupton informacionin e gjeneruar, të dërguar, të marrë ose të ruajtur me anë të mjeteve elektronike, optike, digjitale ose të ngjashme, me rezultatin që informacioni i komunikuar është i arritshëm, në mënyrë që të jetë i përdorshëm për referencë të mëvonshme;

“Faturë elektronike e ngarkesës” nënkupton një faturë ngarkese të lëshuar përmes komunikimit elektronik nga transportuesi, dërguesi ose çdo palë tjetër e interesuar në realizimin e një kontrate

transporti, për të cilën zbatohet Konventa, duke përfshirë të dhëna të lidhura logjikisht me komunikimin elektronik përmes bashkëlidhjeve, ose të lidhura ndryshe me komunikimin elektronik, në mënyrë të njëkohshme ose pas lëshimit të saj, duke u bërë pjesë e faturës elektronike të ngarkesës.

“Nënshkrim elektronik” nënkupton të dhëna në formë elektronike, të cilat janë të bashkëlidhura ose të shoqëruara logjikisht me të dhëna të tjera elektronike dhe të cilat shërbejnë si metodë autentifikimi.

Neni 2

Fusha e zbatimit dhe efekti i faturës elektronike të ngarkesës

1. Në bazë të dispozitave të këtij Protokolli, fatura e ngarkesës së përmendur në Konventë, si dhe çdo kërkim, deklaratë, udhëzim, kërkesë, rezervë ose komunikim tjetër, në lidhje me përmbushjen e një kontrate transporti për të cilën zbatohet Konventa, mund të bëhet me anë të komunikimit elektronik.

2. Një faturë elektronike e ngarkesës që pajtohet me dispozitat e këtij Protokolli, konsiderohet ekuivalente me faturën e ngarkesës së përmendur në Konventë dhe për këtë arsye duhet të ketë të njëjtën vlerë provuese dhe të prodhojë të njëjtat efekte si ajo faturë ngarkese.

Neni 3

Autentifikimi i faturës elektronike të ngarkesës

1. Fatura elektronike e ngarkesës duhet të vërtetohet nga palët në kontratën e transportit me anë të një nënshkrimi elektronik të besueshëm që siguron lidhjen e tij me faturën elektronike të transportit. Besueshmëria e një metode të nënshkrimit elektronik supozohet, përveç nëse provohet ndryshe, nëse nënshkrimi elektronik:

- a) është i lidhur në mënyrë unike me nënshkruesin;
- b) është i aftë të identifikojë nënshkruesin;
- c) krijohet duke përdorur mjete që nënshkruesi mund t'i mbajë nën kontrollin e tij të vetëm; dhe
- d) është i lidhur me të dhënat me të cilat lidhet në një mënyrë të tillë që çdo ndryshim i mëvonshëm i të dhënave është i dallueshëm.

2. Fatura elektronike e ngarkesës mund të autentifikohet edhe me çdo metodë tjetër të autentifikimit elektronik të lejuar nga ligji i vendit në të cilin është hartuar fatura elektronike e ngarkesës.

3. Detajet e përfshira në faturën elektronike të ngarkesës do të jenë të arritshme për çdo palë që ka të drejtë për to.

Neni 4

Kushtet për krijimin e faturës elektronike të ngarkesës

1. Fatura elektronike e ngarkesës duhet të përmbajë të njëjtat detaje si fatura e ngarkesës e përmendur në Konventë.

2. Procedura e përdorur për lëshimin e faturës elektronike të ngarkesës duhet të garantojë integritetin e të dhënave të përfshira në të, që nga koha kur është gjeneruar për herë të parë në formën e saj përfundimtare. Integriteti konsiderohet i plotë kur të dhënat kanë mbetur të plota dhe të pandryshuara, përveç ndonjë shtese ose ndryshimi që lind gjatë rrjedhës normale të komunikimit, ruajtjes dhe shfaqjes.

3. Detajet e përfshira në faturën elektronike të ngarkesës mund të plotësohen ose të ndryshohen në rastet e autorizuar nga Konventa.

Procedura e përdorur për plotësimin ose ndryshimin e faturës elektronike të ngarkesës, duhet të mundësojë zbulimin si të tillë të çdo shtese ose ndryshimi në faturën elektronike të ngarkesës dhe duhet të ruajë të dhënat që përmbahen fillimisht në të.

Neni 5
Zbatimi i faturës elektronike të ngarkesës

1. Palët e interesuara në zbatimin e kontratës së transportit duhet të bien dakord mbi procedurat dhe zbatimin e tyre, në mënyrë që të përmbushin kërkesat e këtij Protokoll dhe të Konventës, në veçanti në lidhje me:

- a) metoda për lëshimin dhe dorëzimin e faturës elektronike të ngarkesës te pala e autorizuar;
- b) një garanci që fatura elektronike e ngarkesës ruan integritetin e saj;
- c) mënyra në të cilën pala e autorizuar për të drejtat që rrjedhin nga fatura elektronike e ngarkesës, është e aftë të provojë këtë të drejtë;
- d) mënyra sesi jepet konfirmimi se dorëzimi të marrësi është kryer;
- e) procedurat për plotësimin ose ndryshimin e faturës elektronike të ngarkesës; dhe
- f) procedurat për zëvendësimin e mundshëm të faturës elektronike të ngarkesës me një faturë ngarkese të lëshuar me mjete të ndryshme.

2. Procedurat në paragrafin 1 duhet të përmenden në faturën elektronike të ngarkesës dhe duhet të jenë lehtësisht të dallueshme.

Neni 6
Dokumente që plotësojnë faturën elektronike të ngarkesës

1. Transportuesi duhet t'i dorëzojë dërguesit, me kërkesë të këtij të fundit, një faturë për mallrat dhe të gjitha informacionet e nevojshme për identifikimin e dërgesës dhe për akses në faturën elektronike të ngarkesës së cilës i referohet ky Protokoll.

2. Dokumentet e përmendura në nenin 6, paragrafi 2 (g), dhe nenin 11 të Konventës mund të ofrohen nga dërguesi te transportuesi në formën e një komunikimi elektronik, nëse dokumentet ekzistojnë në këtë formë dhe nëse palët kanë rënë dakord për procedurat që mundësojnë vendosjen e një lidhjeje midis këtyre dokumenteve dhe faturës elektronike të ngarkesës të cilës i referohet ky Protokoll në një mënyrë që garanton integritetin e tyre.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 7
Nënshkrimi, ratifikimi, aderimi

1. Ky Protokoll do të jetë i hapur për nënshkrim nga Shtetet që janë nënshkruese ose Palë të Konventës dhe janë ose anëtarë të Komisionit Ekonomik për Evropën, ose janë pranuar në Komision në një cilësi konsultative sipas paragrafit 8 të termave të referencës së Komisionit.

2. Ky Protokoll do të jetë i hapur për nënshkrim në Gjenevë nga data 27 deri më 30 maj 2008, përfshirë edhe këtë datë, dhe pas kësaj date, në Selinë e Kombeve të Bashkuara në Nju-Jork deri më 30 qershor 2009, përfshirë edhe këtë datë.

3. Ky Protokoll do t'i nënshtrohet ratifikimit nga Shtetet nënshkruese dhe do të jetë i hapur për aderim nga Shtetet jonënshkruese, të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, të cilat janë Palë në Konventë.

4. Shtetet që mund të marrin pjesë në aktivitete të caktuara të Komisionit Ekonomik për Evropën në përputhje me paragrafin 11 të termave të referencës së Komisionit dhe që kanë aderuar në Konventë, mund të bëhen Palë në këtë Protokoll, duke aderuar në të pas hyrjes së tij në fuqi.

5. Ratifikimi ose aderimi do të kryhet me depozitimin e një instrumenti te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

6. Çdo instrument ratifikimi ose aderimi, i depozituar pas hyrjes në fuqi të një amendamenti të këtij Protokoll, të miratuar në përputhje me dispozitat e nenit 13 më poshtë, do të konsiderohet se zbatohet për Protokollin e ndryshuar nga amendamenti.

Neni 8
Hyrja në fuqi

1. Ky Protokoll hyn në fuqi në ditën e nëntëdhjetë pasi pesë nga Shtetet e përmendura në nenin 7, paragrafi 3 të këtij Protokoll, të kenë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit ose të aderimit.

2. Për çdo shtet që e ratifikon ose aderon në të pasi pesë shtete të kenë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit ose aderimit, ky Protokoll hyn në fuqi në ditën e nëntëdhjetë, pasi shteti në fjalë të ketë depozituar instrumentin e tij të ratifikimit ose aderimit.

Neni 9
Denoncimi

1. Çdo Palë mund ta denoncojë këtë Protokoll, duke njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

2. Denoncimi hyn në fuqi 12 muaj pas datës së marrjes nga Sekretari i Përgjithshëm të njoftimit të denoncimit.

3. Çdo shtet që pushon së qeni palë në Konventë, në të njëjtën datë pushon së qeni palë në këtë Protokoll.

Neni 10
Përfundimi

Nëse, pas hyrjes në fuqi të këtij Protokoll, numri i Palëve reduktohet, si rezultat i denoncimeve, në më pak se pesë, ky Protokoll pushon së qeni në fuqi nga data në të cilën denoncimi i fundit prej këtyre denoncimeve hyn në fuqi. Ai, gjithashtu, pushon së qeni në fuqi nga data kur Konventa pushon së qeni në fuqi.

Neni 11
Mosmarrëveshja

Çdo mosmarrëveshje ndërmjet dy ose më shumë Palëve, në lidhje me interpretimin ose zbatimin e këtij Protokoll, të cilën Palët nuk mund ta zgjidhin me negociata ose mjete të tjera, me kërkesë të cilësdo prej Palëve të interesuara, mund t'i referohet për zgjidhje Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë.

Neni 12
Rezervat

1. Çdo shtet, në kohën e nënshkrimit, ratifikimit ose aderimit në këtë Protokoll, mund të deklarojë me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara se nuk konsiderohet nën detyrimin ligjor nga neni 11 i këtij Protokoll. Palët e tjera nuk do të jenë të detyruara ligjërisht nga neni 11 i këtij Protokoll, në lidhje me asnjë Palë që ka bërë një rezervë të tillë.

2. Deklarata e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, mund të tërhiqet në çdo kohë me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

3. Asnjë rezervë tjetër ndaj këtij Protokoll nuk lejohet.

Neni 13
Amendamentet

1. Pasi ky Protokoll të hyjë në fuqi, ai mund të ndryshohet sipas procedurës së përcaktuar në këtë nen.

2. Çdo ndryshim i propozuar i këtij Protokolli i paraqitur nga një Palë e këtij Protokolli, duhet t'i paraqitet Grupit të Punës për Transportin Rrugor të Komisionit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Evropën (UNECE) për shqyrtim dhe vendim.

3. Palët në këtë Protokoll do të bëjnë të gjitha përpjekjet e mundshme për të arritur konsensus. Nëse, pavarësisht këtyre përpjekjeve, nuk arrihet konsensus mbi amendamentin e propozuar, si mjet i fundit, për miratim do të kërkohet një shumicë prej dy të tretash të Palëve të pranishme dhe votuese. Një amendament i propozuar, i miratuar qoftë me konsensus ose nga një shumicë prej dy të tretash të Palëve, do t'i paraqitet Sekretarit të Përgjithshëm nga Sekretariati i Komisionit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Evropën për t'u shpërndarë për pranim të të gjitha Palët në këtë Protokoll, si dhe të Shtetet nënshkruese.

4. Brenda një periudhe prej nëntë muajsh nga data kur amendamenti i propozuar komunikohet nga Sekretari i Përgjithshëm, çdo Palë mund ta informojë Sekretarin e Përgjithshëm se ka një kundërshtim ndaj amendamentit të propozuar.

5. Amendamenti i propozuar do të konsiderohet i pranuar nëse, deri në fund të periudhës nëntëmuajore të parashikuar në paragrafin pararendës, nuk është njoftuar asnjë kundërshtim nga një Palë e këtij Protokolli. Nëse deklarohet një kundërshtim, amendamenti i propozuar nuk do të ketë efekt.

6. Në rastin e një vendi që bëhet Palë Kontraktuese e këtij Protokolli midis momentit të njoftimit të një propozimi për ndryshim dhe përfundimit të periudhës nëntëmuajore, siç parashikohet në paragrafin 4 të këtij neni, Sekretariati i Grupit të Punës për Transportin Rrugor të Komisionit Ekonomik për Evropën duhet të njoftojë Shtetin e ri Palë për ndryshimin e propozuar sa më shpejt të jetë e mundur. Ky i fundit mund të informojë Sekretarin e Përgjithshëm para përfundimit të kësaj periudhe prej nëntë muajsh se ka një kundërshtim ndaj ndryshimit të propozuar.

7. Sekretari i Përgjithshëm do të njoftojë, sa më shpejt të jetë e mundur, të gjitha Palët për kundërshtimet e ngritura në përputhje me paragrafët 4 dhe 6 të këtij neni, si dhe për çdo ndryshim të pranuar sipas paragrafit 5 më sipër.

8. Çdo ndryshim që konsiderohet i pranuar, hyn në fuqi gjashtë muaj pas datës së njoftimit të një pranimi të tillë nga Sekretari i Përgjithshëm drejtuar Palëve.

Neni 14

Thirrja e një konference diplomatike

1. Pasi ky Protokoll të hyjë në fuqi, çdo Palë mund të kërkojë, me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, që të thirret një konferencë, me qëllim shqyrtimin e këtij Protokolli. Sekretari i Përgjithshëm do të njoftojë të gjitha Palët për kërkesën dhe një konferencë shqyrtimi do të thirret nga Sekretari i Përgjithshëm nëse, brenda një periudhe prej katër muajsh pas datës së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm, jo më pak se një e katërta e Palëve të këtij Protokolli e njoftojnë atë për pajtueshmërinë e tyre me kërkesën.

2. Nëse thirret një konferencë në përputhje me paragrafin pararendës, Sekretari i Përgjithshëm do të njoftojë të gjitha Palët dhe do t'i ftojë të paraqesin brenda një periudhe prej tre muajsh, propozime që ato dëshirojnë që Konferenca t'i shqyrtojë. Sekretari i Përgjithshëm do t'u qarkullojë të gjitha Palëve rendin e ditës paraprak të Konferencës, së bashku me tekstet e këtyre propozimeve të paktën tre muaj para datës në të cilën do të thirret Konferenca.

3. Sekretari i Përgjithshëm do të ftojë në çdo konferencë të thirrur në përputhje me këtë nen, të gjitha Shtetet e përmendura në nenin 7, paragrafët 1, 3 dhe 4 të këtij Protokolli.

Neni 15

Njoftimet për Shtetet

Përveç njoftimeve të parashikuara në nenet 13 dhe 14, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të njoftojë Shtetet e përmendura në nenin 7, paragrafi 1 më sipër, dhe Shtetet që janë bërë Palë në këtë Protokoll, në përputhje me paragrafët 3 dhe 4 të nenit 7, për:

- a) ratifikimet dhe aderimet sipas nenit 7;
- b) datat e hyrjes në fuqi të këtij Protokolli, në përputhje me nenin 8;
- c) denoncimet sipas nenit 9;
- d) përfundimi i këtij Protokolli, në përputhje me nenin 10;
- e) deklaratat dhe njoftimet e marra, në përputhje me nenin 12, paragrafët 1 dhe 2.

Neni 16

Depozitari

Originali i këtij Protokolli do të depozitohet te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, i cili do t'u dërgojë kopje të vërtetuara të tij të gjitha shteteve të përmendura në nenin 7, paragrafët 1, 3 dhe 4 të këtij Protokolli.

Bërë në Gjenevë, më njëzet shkurt, dy mijë e tetë, në një kopje të vetme në gjuhët angleze dhe frënge, ku secili tekst është njëllë autetik.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, duke qenë të autorizuar sipas rregullave për këtë, kanë nënshkruar këtë Protokoll.

**ADDITIONAL PROTOCOL TO THE CONVENTION ON
THE CONTRACT FOR THE INTERNATIONAL CARRIAGE OF
GOODS BY ROAD (CMR) CONCERNING THE ELECTRONIC
CONSIGNMENT NOTE**

The Parties to this Protocol,

Being Parties to the Convention on the Contract for the International Carriage of Goods by Road (CMR), done at Geneva on 19 May 1956,

Desirous of supplementing the Convention in order to facilitate the optional making out of the consignment note by means of procedures used for the electronic recording and handling of data,

Have agreed as follows:

Article 1
Definitions

For the purposes of this Protocol,

“Convention” means the Convention on the Contract for the International Carriage of Goods by Road (CMR);

“Electronic communication” means information generated, sent, received or stored by electronic, optical, digital or similar means with the result that the information communicated is accessible so as to be usable for subsequent reference;

“Electronic consignment note” means a consignment note issued by electronic communication by the carrier, the sender or any other party interested in the performance of a contract of carriage to which the Convention applies, including particulars logically associated with the electronic communication by attachments or otherwise linked to the electronic communication contemporaneously with or subsequent to its issue, so as to become part of the electronic consignment note;

“Electronic signature” means data in electronic form which are attached to or logically associated with other electronic data and which serve as a method of authentication.

Article 2
Scope and effect of the electronic consignment note

1. Subject to the provisions of this Protocol, the consignment note referred to in the Convention, as well as any demand, declaration, instruction, request, reservation or other communication relating to the performance of a contract of carriage to which the Convention applies, may be made out by electronic communication.
2. An electronic consignment note that complies with the provisions of this Protocol shall be considered to be equivalent to the consignment note referred to in the Convention and shall therefore have the same evidentiary value and produce the same effects as that consignment note.

Article 3
Authentication of the electronic consignment note

1. The electronic consignment note shall be authenticated by the parties to the contract of carriage by means of a reliable electronic signature that ensures its link with the electronic consignment note. The reliability of an electronic signature method is presumed, unless otherwise proved, if the electronic signature:
 - (a) is uniquely linked to the signatory;
 - (b) is capable of identifying the signatory;
 - (c) is created using means that the signatory can maintain under his sole control; and
 - (d) is linked to the data to which it relates in such a manner that any subsequent change of the data is detectable.
2. The electronic consignment note may also be authenticated by any other electronic authentication method permitted by the law of the country in which the electronic consignment note has been made out.
3. The particulars contained in the electronic consignment note shall be accessible to any party entitled thereto.

Article 4

Conditions for the establishment of the electronic consignment note

1. The electronic consignment note shall contain the same particulars as the consignment note referred to in the Convention.
2. The procedure used to issue the electronic consignment note shall ensure the integrity of the particulars contained therein from the time when it was first generated in its final form. There is integrity when the particulars have remained complete and unaltered, apart from any addition or change which arises in the normal course of communication, storage and display.
3. The particulars contained in the electronic consignment note may be supplemented or amended in the cases authorized by the Convention.

The procedure used for supplementing or amending the electronic consignment note shall make it possible to detect as such any supplement or amendment to the electronic consignment note and shall preserve the particulars originally contained therein.

Article 5

Implementation of the electronic consignment note

1. The parties interested in the performance of the contract of carriage shall agree on the procedures and their implementation in order to comply with the requirements of this Protocol and the Convention, in particular as regards:
 - (a) The method for the issuance and the delivery of the electronic consignment note to the entitled party;
 - (b) An assurance that the electronic consignment note retains its integrity;
 - (c) The manner in which the party entitled to the rights arising out of the electronic consignment note is able to demonstrate that entitlement;
 - (d) The way in which confirmation is given that delivery to the consignee has been effected;
 - (e) The procedures for supplementing or amending the electronic consignment note; and

- (f) The procedures for the possible replacement of the electronic consignment note by a consignment note issued by different means.
2. The procedures in paragraph 1 must be referred to in the electronic consignment note and shall be readily ascertainable.

Article 6

Documents supplementing the electronic consignment note

1. The carrier shall hand over to the sender, at the latter's request, a receipt for the goods and all information necessary for identifying the shipment and for access to the electronic consignment note to which this Protocol refers.
2. The documents referred to in Article 6, paragraph 2 (g) and Article 11 of the Convention may be furnished by the sender to the carrier in the form of an electronic communication if the documents exist in this form and if the parties have agreed to procedures enabling a link to be established between these documents and the electronic consignment note to which this Protocol refers in a manner that assures their integrity.

FINAL PROVISIONS

Article 7

Signature, ratification, accession

1. This Protocol shall be open for signature by States which are signatories to or Parties to the Convention and are either members of the Economic Commission for Europe or have been admitted to the Commission in a consultative capacity under paragraph 8 of the Commission's terms of reference.
2. This Protocol shall be open for signature at Geneva from 27 to 30 May 2008 inclusive and after this date, at United Nations Headquarters in New York until 30 June 2009 inclusive.
3. This Protocol shall be subject to ratification by signatory States and open for accession by non-signatory States, referred to in paragraph 1 of this article, which are Parties to the Convention.
4. Such States as may participate in certain activities of the Economic Commission for Europe in accordance with paragraph 11 of the Commission's

terms of reference and which have acceded to the Convention may become Parties to this Protocol by acceding thereto after its entry into force.

5. Ratification or accession shall be effected by the deposit of an instrument with the Secretary-General of the United Nations.

6. Any instrument of ratification or accession, deposited after the entry into force of an amendment to this Protocol adopted in accordance with the provisions of Article 13 hereafter, shall be deemed to apply to the Protocol as modified by the amendment.

Article 8 Entry into force

1. This Protocol shall enter into force on the ninetieth day after five of the States referred to in article 7, paragraph 3, of this Protocol, have deposited their instruments of ratification or accession.

2. For any State ratifying or acceding to it after five States have deposited their instruments of ratification or accession, this Protocol shall enter into force on the ninetieth day after the said State has deposited its instrument of ratification or accession.

Article 9 Denunciation

1. Any Party may denounce this Protocol by so notifying the Secretary-General of the United Nations.

2. Denunciation shall take effect 12 months after the date of receipt by the Secretary-General of the notification of denunciation.

3. Any State which ceases to be Party to the Convention shall on the same date cease to be Party to this Protocol.

Article 10 Termination

If, after the entry into force of this Protocol, the number of Parties is reduced, as a result of denunciations, to less than five, this Protocol shall cease to be in force from the date on which the last of such denunciations takes

effect. It shall also cease to be in force from the date on which the Convention ceases to be in force.

Article 11 Dispute

Any dispute between two or more Parties relating to the interpretation or application of this Protocol which the Parties are unable to settle by negotiation or other means may, at the request of any one of the Parties concerned, be referred for settlement to the International Court of Justice.

Article 12 Reservations

1. Any State may, at the time of signing, ratifying, or acceding to this Protocol, declare by a notification addressed to the Secretary-General of the United Nations that it does not consider itself bound by article 11 of this Protocol. Other Parties shall not be bound by article 11 of this Protocol in respect of any Party which has entered such a reservation.
2. The declaration referred to in paragraph 1 of this article may be withdrawn at any time by a notification addressed to the Secretary-General of the United Nations.
3. No other reservation to this Protocol shall be permitted.

Article 13 Amendments

1. Once this Protocol is in force, it may be amended according to the procedure defined in this article.
2. Any proposed amendment to this Protocol presented by a Party to this Protocol shall be submitted to the Working Party on Road Transport of the United Nations Economic Commission for Europe (UNECE) for consideration and decision.
3. The Parties to this Protocol shall make all possible efforts to achieve consensus. If, despite these efforts, consensus is not reached on the proposed amendment, it shall require, as a last resort, for adoption a two-thirds majority of Parties present and voting. A proposed amendment adopted either by

consensus or by a two-thirds majority of Parties shall be submitted by the secretariat of the United Nations Economic Commission for Europe to the Secretary-General to be circulated for acceptance to all Parties to this Protocol, as well as to signatory States.

4. Within a period of nine months from the date on which the proposed amendment is communicated by the Secretary-General, any Party may inform the Secretary-General that it has an objection to the amendment proposed.

5. The proposed amendment shall be deemed to have been accepted if, by the end of the period of nine months foreseen in the preceding paragraph, no objection has been notified by a Party to this Protocol. If an objection is stated, the proposed amendment shall be of no effect.

6. In the case of a country which becomes a Contracting Party to this Protocol between the moment of notification of a proposal for amendment and the end of the nine-month period foreseen in paragraph 4 of this article, the secretariat of the Working Party on Road Transport of the Economic Commission for Europe shall notify the new State Party about the proposed amendment as soon as possible. The latter may inform the Secretary-General before the end of this period of nine months that it has an objection to the proposed amendment.

7. The Secretary-General shall notify, as soon as possible, all the Parties of objections raised in accordance with paragraphs 4 and 6 of this Article as well as of any amendment accepted according to paragraph 5 above.

8. Any amendment deemed to have been accepted shall enter into force six months after the date of notification of such acceptance by the Secretary-General to Parties.

Article 14 Convening of a diplomatic conference

1. Once this Protocol is in force, any Party may, by notification to the Secretary-General of the United Nations, request that a conference be convened for the purpose of reviewing this Protocol. The Secretary-General shall notify all Parties of the request and a review conference shall be convened by the Secretary-General if, within a period of four months following the date of notification by the Secretary-General, not less than one fourth of the Parties to this Protocol notify him of their concurrence with the request.

2. If a conference is convened in accordance with the preceding paragraph, the Secretary-General shall notify all the Parties and invite them to submit within a period of three months such proposals as they may wish the Conference to consider. The Secretary-General shall circulate to all Parties the provisional agenda for the Conference together with the texts of such proposals at least three months before the date on which the Conference is to meet.

3. The Secretary-General shall invite to any conference convened in accordance with this article all States referred to in Article 7, paragraphs 1, 3 and 4, of this Protocol.

Article 15 Notifications to States

In addition to the notifications provided for in Articles 13 and 14, the Secretary-General of the United Nations shall notify the States referred to in Article 7, paragraph 1, above, and the States which have become Parties to this Protocol in accordance with paragraphs 3 and 4 of Article 7, of:

- (a) Ratifications and accessions under Article 7;
- (b) The dates of entry into force of this Protocol in accordance with Article 8;
- (c) Denunciations under Article 9;
- (d) The termination of this Protocol in accordance with Article 10;
- (e) Declarations and notifications received in accordance with Article 12, paragraphs 1 and 2.

Article 16 Depositary

The original of this Protocol shall be deposited with the Secretary-General of the United Nations, who shall send certified true copies thereof to all the States referred to in Article 7, paragraphs 1, 3 and 4, of this Protocol.

DONE at Geneva, this twentieth day of February two thousand and eight, in a single copy in the English and French languages, each text being equally authentic.